

## Vendim nr. 129 datë 10.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 10.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (G) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** GAZMOR GURI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-5485 (442), datë 12.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Në periudhën 29.10.2012 - 07.04.2014 kërkuesi ka ushtruar funksionin e drejtorit të Drejtorisë së Inspektimeve në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm (*SHKB*). Për shkak të pozicionit të tij të punës, bazuar në ligjin nr. 10002, datë 06.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme” (*ligji nr. 10002/2008*), vendimin nr. 600, datë 12.09.2007 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me strehim të nëpunësve të

administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, të ndryshuar (VKM nr. 600/2007), si dhe marrëveshjen e lidhur me Bankën Kombëtare Tregtare (BKT), me shkresën nr.G-9/1 prot., datë 24.04.2013, Ministria e Brendshme i ka dërguar BKT-së listën e subjekteve përftuese për strehim, ku përfshihej edhe kërkuesi, me qëllim që ky i fundit të financohej me kredi me kushte të buta në shumën 5.000.000 lekë.

2. Në datën 02.10.2013 kërkuesi dhe shtetasja K.G. kanë lidhur me BKT-në kontratën e kredisë me nr. 828 rep. dhe nr. 489 kol., me kushte kreditimi lehtësuese, në zbatim të së cilës BKT-ja ka vijuar me disbursimin e kredisë. Si pasojë e një procedure auditimi të kryer në Entin Kombëtar të Banesave (EKB) nga Sektori i Auditit të Brendshëm për periudhën 15.01.2014-15.03.2014, ky i fundit ka vlerësuar se kërkuesi kishte përfituar subvencion në kundërshtim me VKM-në nr. 600/2007, pasi kishte 11 muaj në pozicionin e drejtorit të drejtorisë në SHKB dhe jo 2 vjet, siç parashikonte VKM-ja. Për këtë shkak, me shkresën nr. 3642/2, datë 22.09.2014, EKB-ja ka njoftuar BKT-në se procedura e miratimit të kredisë së kërkuesit nga Ministria e Brendshme binte në kundërshtim me pikën 6, shkronja “d”, të VKM-së nr. 600/2007, ndaj, bazuar edhe në pikën 21/1 të udhëzimit nr. 6257, datë 02.03.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti” (udhëzimi nr. 6257/2008), të ndryshuar, kërkuesit do t’i ndërpritej subvencioni i interesave të kredisë.

3. Me shkresën nr. 8104/1 prot., datë 29.09.2014 të BKT-së, kërkuesi është njoftuar se kredia e marrë do të kthehej në kredi tregtare, konform parashikimeve të kontratës së kredisë. Duke mos qenë dakord me veprimet e EKB-së dhe të BKT-së për ndërprerjen e subvencionit të kredisë, në datën 12.11.2014 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi për kundërshtimin e shkresës nr. 3642/2, datë 22.09.2014 të EKB-së, të njoftuar me shkresën nr. 8104/1 prot., datë 29.09.2014 të BKT-së.

4. Me vendimin nr. 77, datë 19.01.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesit. Në analizë të pikave 6, shkronja “d” e 8, të VKM-së nr. 600/2007 dhe pikave 19/1 e 21/1 të udhëzimit nr. 6257/2008, gjykata ka vlerësuar se kërkuesi nuk përmbushte kushtin e përfitimit të kredisë që lidhej me kohën e ushtrimit të detyrës, konkretisht afatin 2-vjeçar. Po sipas gjykatës, kërkuesi jo vetëm nuk kishte mbushur periudhën 2-vjeçare në detyrë në kohën e lidhjes së kontratës, por edhe marrëdhënia e posaçme e shërbimit në funksion nuk i kishte mbushur 2 vjet. Nga ana tjetër, kërkuesi kishte qenë në dijeni të faktit se, nëse vërtetoheshin pavërtetësi në deklaram dhe/ose rrethana të rreme, si pavërtetësia e kushtit mbi periudhën e kërkuar të qëndrimit në detyrë, kredia do të

konvertohej në kredi me kushte tregtare dhe ky përcaktim rezultonte i shprehur edhe në kontratën e kredisë së nënshkruar mes tij dhe BKT-së.

5. Bazuar në ankimin e kërkuarit, me vendimin nr. 3430, datë 26.10.2016, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, shfuqizimin aktit administrativ të EKB-së për njoftimin e kërkuarit në lidhje me ndërprerjen e subvencionit, si dhe detyrimin e EKB-së t'i paguajë kërkuarit pjesën e interesave të kredisë që subvencionohen nga shteti, sipas VKM-së nr. 600/2007. Sipas gjykatës së apelit, në referim të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gabimet e kryera nga organet shtetërore në verifikimet përpara lidhjes së kontratës së kredisë duhej të mbuloheshin nga shteti dhe jo të rëndonin individin e përfshirë në çështje. Po sipas saj, nxjerrja e aktit për revokimin e përfitimit të kërkuarit, si e drejtë që buronte nga neni 56 i ligjit nr. 10002/2008, ishte bërë në bazë të dispozitave nënligjore që nuk kishin qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së tij, pasi me vendimin nr. 56, datë 05.02.2014 (*vendimi nr. 56/2014*), Këshilli i Ministrave kishte vendosur shfuqizimin e VKM-së nr. 600/2007 dhe të çdo akti tjetër nënligjor të nxjerrë në zbatim të tij. Në këto rrethana, akti nr. 3642/2 prot., datë 22.09.2014, i EKB-së nuk kishte mbështetje ligjore.

6. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit kanë ushtruar rekurs EKB-ja dhe Avokatura e Shtetit, ndërsa kërkuari kundërrekurs.

7. Me vendimin nr. 00-2023-5485 (442), datë 12.12.2023, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke vlerësuar se vendimi i kësaj të fundit ishte marrë në zbatim dhe interpretim të drejtë të ligjit material në lidhje me rrethanat konkrete të çështjes, ndërsa analiza ligjore e gjykatës së apelit nuk ishte në përputhje me ligjin material të zbatueshëm.

8. Në datën 11.04.2024 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

## II

### Pretendimet e kërkuarit

9. **Kërkuari**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

9.1.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi arsytimi i Gjykatës së Lartë se mosushtrimi i rregullt i detyrës në evidentimin e rasteve që nuk përmbushin kriteret për të përfituar subvencionim të kredisë për strehim ose

diligjenca e ulët e organeve publike në vlerësimin e përputhshmërisë së kërkesave me kërkesat normative nuk e përjashtojnë përfituesin nga përgjegjësia dhe pasojat e përcaktuara në pikat 8 dhe 9 të VKM-së nr. 600/2007, është alogjik dhe në kundërshtim me pikën 9 të kësaj VKM-je, e cila përcakton qartë se konvertimi i subvencionit në kredi tregtare bëhet vetëm kur përfituesi ka bërë deklaram të rremë ose ka paraqitur rrethana të rreme dhe jo kur organi përzgjedhës ka bërë vlerësim të gabuar të përfituesve. Parregullsia e organit publik nuk mund të sjellë pasoja negative ndaj tij me argumentin se në momentin e paraqitjes së kërkesës ai kishte dijeni se nuk plotësonte kushtin e viteve në punë. Po kështu, neni 56 i ligjit nr. 10002/2008 parashikon të drejtën e punonjësve të SHKB-së për të përfituar kredi strehimi, sipas kriterëve të përcaktuara me VKM, ndërkohë që ligji nuk përcakton se cili nga vendimet e Këshillit të Ministrave rregullon kriteret e fitimit të kredisë. Përveç VKM-së nr. 600/2007 mund të ketë edhe vendime të tjera që përcaktojnë rregulla përfitimi, por është organi publik ai që vlerëson plotësimin ose jo të kushteve për kredi.

9.1.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi VKM-ja nr. 600/2007 parashikon mundësinë e revokimit të së drejtës vetëm në rastet kur përfituesi ka paraqitur rrethana të rreme dhe jo për shkak të vlerësimit të gabuar të bërë nga organi shtetëror. Verifikimi i kriterit ligjor në lidhje me kushtet e përfitimit të kredisë ka qenë detyrim i organit publik dhe kapërcimi i këtij verifikimi ka konvertuar të drejtën e tij në një të drejtë të fituar, e cila nuk mund të shuhet për këtë shkak.

9.2. *E drejta për jetë private*, pasi vendimi i marrë nga EKB-ja për heqjen e rimbursimit të kredisë ka sjellë pasoja negative në gjendjen ekonomike të familjes së tij, duke rritur në mënyrë të papërbalueshme këstin e kredisë mujore, çka ka rënduar në mënyrë drastike gjendjen e tij, pasi e ka plotësisht të pamundur të mbajë dhe paguajë banesën.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkesit

10. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në proces dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për jetë private, ndërkohë që nuk ka vënë në dispozicion të Gjykatës asnjë akt, dokument ose provë që të provojë shterimin e mjeteve juridike në dispozicion për këtë kërkim. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, që nënkupton se u takon palëve të parashtruesit argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre (*shih vendimet nr. 57, datë 25.07.2017; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 45, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në kushtet kur kërkuesi nuk ka arritur të provojë përpara Gjykatës se ka shteruar mjetet juridike efektive në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për jetë private, Kolegji vlerëson se ky pretendim i tij nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kushtet kur pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor ngrihet ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë, për kundërshtimin e të cilit kërkuesi nuk ka mjetet të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual, ndërsa pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike rezulton të jenë parashtruar prej tij në kundërrekurs, Kolegji çmon se në lidhje me to ai i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës.

15. Në drejtim të legjitimitit *ratione temporis*, Kolegji vëren se neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në çështjen në shqyrtim, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 12.12.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 11.04.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të sigurisë juridike, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

17. Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, Kolegji konstaton se ai ngrihet në drejtim të të drejtave të fituara. Në këtë aspekt, Kolegji thekson se në lidhje me procesin e rregullt ligjor, siguria juridike është parë nga Gjykata në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, e cila nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 71, datë 13.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuesit në lidhje me sigurinë juridike në drejtim të të drejtave të fituara kanë të bëjnë me vendimin e organit publik, konkretisht SHKB-së, i cili ka vlerësuar se kërkuesi përfshihej në subjektet të cilat, në zbatim

të legjisllacionit në fuqi, mund të përfitonin kredi me kushte lehtësuese nga shteti. Ndërkohë, nuk rezulton që kërkuesi të ketë fituar një të drejtë të tillë me vendim gjyqësor të formës së prerë, ndaj, në këtë aspekt, Kolegji çmon se pretendimet e tij për cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara nuk gjejnë mbështetje në këndvështrimin kushtetues.

19. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit, të cilat kanë të bëjnë me standardin e arsytimit të vendimit nga Gjykata e Lartë, Kolegji vlerëson t'i analizojë ato në vijim.

#### *B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

20. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë është alogjik në pjesën që arsyeton se mosushtrimi i rregullt i detyrës në evidentimin e rasteve që nuk përmbushin kriteret për të përfituar subvencionim të kredisë për strehim ose diligenca e ulët e organeve publike në vlerësimin e përputhshmërisë së kërkesave me kërkesat normative, nuk përjashton nga përgjegjësia dhe pasojat e përcaktuara në pikat 8 dhe 9 të VKM-së nr. 600/2007. Sipas tij, pika 9 e kësaj VKM-je përcakton qartë se konvertimi i subvencionit në kredi tregtare bëhet vetëm kur përfituesi ka bërë deklaram të rremë ose ka paraqitur rrethana të rreme dhe jo kur organi përzgjedhës ka bërë vlerësim të gabuar të përfituesve. Parregullsia e organit publik nuk mund të sjellë pasojë negative ndaj tij me argumentin se kërkesa është bërë me dijeninë se ai nuk plotësonte kushtin e viteve në punë.

21. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Po sipas Gjykatës, është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin

42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret, në analizë të vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se kjo gjykatë ka parashtruar faktet dhe rrethanat e çështjes, si dhe qëndrimet e mbajtura nga gjykatat më të ulëta në lidhje me pretendimet e kërkuarit për kundërshtimin e aktit të EKB-së, përmes së cilit është ndërprerë subvencioni i interesave të kredisë së tij, duke mos u konsideruar më si e subvencionuar nga shteti. Kështu, Gjykata e Lartë ka evidentuar se, në analizë të akteve ligjore në fuqi, gjykata e rrethit ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit, për shkak të mospërmbushjes nga ai të kriterit të ushtrimit të detyrës pa ndërprerje për një periudhë 2-vjeçare, të parashikuar në pikën 6, shkronja “d”, të VKM-së nr. 600/2007 dhe se ky kusht nuk mund të riparohej edhe pas lidhjes së kontratës, për shkak se marrëdhënia e posaçme e tij në funksionin publik nuk i kishte mbushur 2 vjet. Po kështu, Gjykata e Lartë ka evidentuar edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Administrative e Apelit, sipas së cilës nxjerrja e aktit për revokimin e përfitimit të kërkuarit ishte bërë bazuar në dispozita ligjore që nuk kishin qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së tij, pasi me vendimin nr. 56//2014 Këshilli i Ministrave kishte vendosur shfuqizimin e VKM-së nr. 600/2007 dhe çdo akti tjetër nënligjor të nxjerrë në zbatim të tij (*shih faqet 1-7 të vendimit nr. 00-2023-5485 (442), datë 12.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

24. Në këndvështrim të parashikimeve ligjore në fuqi përkundrejt qëndrimit të mbajtur nga gjykatat më të ulëta, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë ishte marrë në zbatim korrekt të ligjit dhe se arsyetimi i gjykatës së apelit se lehtësitë e kredisë bankare duhej të vazhdonin, ndonëse kërkuari nuk ushtronte më të njëjtën detyrë shtetërore për shkak të së cilës kishte përfitur kredinë, nuk ishte në përputhje me ligjin material të zbatueshëm. Po sipas Gjykatës së Lartë, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, gjykata e apelit u kishte dhënë kuptim të ndryshëm fakteve në themel të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Mosushtrimi i rregullt i detyrës në evidentimin e rasteve që nuk përmbushnin kriteret për të përfitur subvencionim të kredisë për strehim ose diligenca e ulët e organeve publike në vlerësimin e përputhshmërisë së kërkesave me kërkesat normative, nuk përjashtonte nga përgjegjësia dhe pasojat e përcaktuara në pikat 8 dhe 9 të VKM-së nr. 600/2007, ndaj, me të drejtë, gjykata administrative e shkallës së parë e kishte gjetur të bazuar përgjegjësinë dhe



pasojat e veprimeve të kërkuarit, i cili e kishte paraqitur kërkesën me deklaratime të rreme, me rëndësi për pasojat e krijuara. Për më tepër, sipas Gjykatës së Lartë, në kundërrekurs kërkuari kishte pretenduar se, në përputhje me VKM-në nr. 600/2007, kishte plotësuar deklaratë që pranonte ndryshimin e kushteve të kredisë, e cila ishte shprehur edhe në kontratën e kredisë së lidhur me bankën. Nga ana tjetër, në lidhje me pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se, në respektim të qartësisë së normës, VKM-ja nr. 600/2007 parashikonte mundësinë e revokimit të së drejtës dhe rastet përkatëse kur duhej të kryhej ky veprim administrativ (*shih faqet 8-10 të vendimit nr. 00-2023-5485 (442), datë 12.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

25. Në vlerësim të vendimmarrjeve të mësipërme, Kolegji çmon se, në kundërshtim nga sa kërkuari pretendonte, Gjykata e Lartë ka marrë në analizë argumentet e parashtruara prej tij në kundërrekurs dhe ka dhënë përgjigje të arsyetuar për shkaqet në të cilat ka mbështetur qëndrimin e saj për shfuqizimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të gjykatës së shkallës së parë, duke i dhënë mundësinë kërkuarit në këtë mënyrë të dëgjohet për pretendimet e tij. Po kështu, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk rezulton alogjik, kontradiktor, i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e bërë ose arbitrar në këndvështrimin kushtetues. Për më tepër, në vlerësim të argumenteve të kërkuarit në tërësi, Kolegji vlerëson se ato kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga Gjykata e Lartë, çka përfshihet brenda kompetencave dhe funksionit të kësaj gjykate, si gjykatë ligji. Në këto kushte, për sa kohë që vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara.

26. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

